



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

Departamenti i Infrastrukturës së Ndërtesave Arsimore

UDHËZUES PËR MIRËMBAJTJE DHE MBROJTJE
TË OBJEKTEVE ARSIMORE



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
*Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i
Tehnologija-Ministry of Education Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 306101-B
Datë: 15.07.2015

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nimit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L - 113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shqiptare dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare, nr. 7/ 01 mars 2019), nën 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

V E N D I M

1. Miratohet Udhëzuesi për mirëmbajtje dhe mbrojtje të objekteve arsimore.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe me qëllim që të shërbej si udhëzues për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së ndërtesave arsimore në mënyrë që të kenë përvojat dhe praktikat e mira në mbrojtjen e objekteve arsimore nga degradimi gradual, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit/MASHT;
2. Zyrës së SP/MASHT;
3. DAP/MASHT;
4. Arkivit.



Ministër/MASHT

HYRJE

Udhëzuesi për mirëmbajtje dhe mbrojtje të objekteve arsimore hartohet bazuar në planin strategjik të arsimit (PSAK 2017-2021) të Republikës së Kosovës. Po ashtu, udhëzuesi është në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e objekteve në institucionet arsimore të të gjitha niveleve.

Hartimi i **Udhëzuesit për Mirëmbajtje dhe Mbrojtje të Objekteve Arsimore** është kryer nga zyrtarët e MASHT-it të të gjitha fushave të angazhuar me vendimin nr. 2-1788 të datës 14.09.2018 të Sekretarit të përgjithshëm në MASHT dhe janë :

Isuf Gashi – udhëheqës i div. për plan. dhe standarde të hapësirave shkollore

Fatmir Bytyqi – këshilltar politik i ministrit

Naim Demiri – u. d. i udhëheqësit të div. për menaxhimin e proj. dhe obj.shkollore

Bajram Beqiraj – zyrtar për menaxhimin e projekteve

Rina Ponosheci – zyrtare për planifikim të hapësirave shkollore

Musa Shala – zyrtar për norma dhe standarde të hapësirave shkollore

Fehmi Krasniqi – zyrtar për planprograme

Sahit Berisha – zyrtar për bashkëpunim me DKA, prindër dhe nxënës

Leonora Shala – koordinatorë për shkollat promovuese të shëndetit

Habib Aliu—inspektor i arsimit

Hazbije Lahu- zyrtare për statistika

Burim Gashi – zyrtar për arsim të lartë

Elhame Shabani – zyrtare për hartim dhe harmonizim të legjislacionit

Jonuz Salihaj –drejtor i drejtorisë së arsimit në Prishtinë

Skender Susuri – drejtor i drejtorisë së arsimit në Prizren.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Deveria - Vlada-Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministrastvo za Obrazovanje, Nauke i
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelaria e Generalnog Sekretara/Office of the General
Secretary

Numër: 2-1766
Datë: 14.08.2018

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të
nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta
zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë
administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive më 22.03.2011 dhe në bazë të kërkesës
me nr. 5-1-1788 e dt. 24.08.2018 nxjerr:

V E N D I M Për emërimin e grupit punues

1. Emërohet grupi punues për hartim të udhëzuesit për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e hapësirave
shkollore, me këtë përbërje:

- 1.1. Isuf Gashi – Udhëheqës i divizionit për planifikim dhe standarde të HSH, kryesues;
- 1.2. Fatmir Bytyqi – Këshilltar politik i Ministrit – MASHT, anëtar;
- 1.3. Naim Demir – ud. Udhëheqës i divizionit për M.P.O.SH, anëtar;
- 1.4. Bajram Beqiraj – Zyrtar për menaxhimin e projekteve, anëtar;
- 1.5. Rina Ponoseci – Zyrtar për planifikim të hapësirave shkollore, anëtar;
- 1.6. Musa Shala – Zyrtar për norma dhe standarde të hapësirave shkollore, anëtar;
- 1.7. Fehmi Krasniqi – zyrtar për planprogram, anëtar;
- 1.8. Sait Berisha – zyrtar për bushkëpunim me DKA, Prindër dhe nxënës, anëtar;
- 1.9. Leonora Shala – koordinatore për shkollat profesionale të shkollat prof. të shëndetit,
anëtare;
- 1.10. Habib Ali – Inspektor i Arsimit, anëtar;
- 1.11. Hazbije Lahu – Zyrtare për statistika, anëtare;
- 1.12. Burim Gashi – Zyrtar për cilësi në Arsimin e Lartë, anëtar;
- 1.13. Elham Shabani – Zyrtare për hartim dhe harmonizim të legjisllacionit, anëtare;
- 1.14. Jonuz Salihaj – Drejtor i DKA-së në Prishtinë, anëtar;
- 1.15. Skender Susari – Drejtor i DKA-së në Prizren, anëtar.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, si dhe në bazë të kërkesës me
nr.5-1-1788 e dt. 24.08.2018 për emërimin e grupit punues për hartim të udhëzuesit për
mirëmbajtjen dhe ruajtjen e hapësirave shkollore, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Të lartpërmendurve;
2. Zyrës së SP/MASHT;
3. DPAP/MASHT
4. Arkiv.





Çka kuptojmë me mirëmbajtje të objekteve arsimore

Mirëmbajtja është aktivitet i vazhdueshëm dhe i përditshëm në shkollë. Është përgjegjësi ligjore që duhet të organizohet në mënyrë sistematike dhe proaktive. Mirëmbajtja e ndërtesës mund të definohet edhe si çdo punë që ndërmerret që të rivendoset (riparohet), çdo pjesë e ndërtesës, shërbimet e saj dhe rrethina deri në një standard të pranueshëm e kështu të mbahet përdorshmëria dhe vlera e ndërtesës.

Ndërtesat që mirëmbahen mund të përdoren me produktivitet dhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë jetës së saj, derisa ndërtesat që nuk mirëmbahen degradohen gradualisht dhe bëhen të papërdorshme dhe mandej duhet të vijë deri te demolimi.

Mirëmbajtja duhet të kuptohet ndryshe nga renovimet të cilat zakonisht janë në shkallë të madhe të aktivitetit , investimeve dhe kohës.

Ky dokument ka për qëllim të udhëzoj personat përgjegjës në institucione edukativo-arsimore shkencore dhe institutet hulumtuese për krijimin e kushteve dhe hapësirave sipas udhëzuesit për norma dhe standarde të ndërtesave arsimore të të gjitha niveleve dhe të mbështetura në standardet evropiane (ISO).



Dedikimi

Ky udhëzues ju shërben (si konsultues) përgjegjësve të institucioneve edukative dhe arsimore parauniversitare, universitare dhe komunave pronësi e të cilave janë objektet shkollore të arsimit parauniversitar. Gjithashtu edhe MASHT-it si themelues i institucioneve arsimore.

Synimi

Me këtë dokument synohet :

- Që të ndahen njohuritë, përvoja dhe praktikat e mira të fituara dhe ndarja e përgjegjësi në mirëmbajtjen e ndërtesave të institucioneve edukativo-arsimore dhe shkencore.
- Që të shtohet efikasiteti dhe niveli kualitativ i mirëmbajtjes si në aspektin higjieno-teknike dhe ndërtimore përmes të cilit arrihet edhe të ketë shpenzime më të vogla në funksionim gjatë shfrytëzimit .
- Të rritet vetëdijesimi për shfrytëzuesit e ndërtesave si dhe komunitetit për krijimin e mjediseve të shëndetshme në bazë të standardeve .
- Të arrihet nivel i mirë dhe i sigurt i hapësirave të nevojshme sipas udhëzuesit për norma dhe standarde

të ndërtesave shkollore dhe me standardet evropiane për mundësitë e zbatimit të plotë të kurrikulave arsimore në të gjitha nivelet arsimore

Me mirëmbajtjen e objekteve të institucioneve edukativo-arsimore shkencore dhe hulumtuese mbrohen dhe kursehen investimet kapitale përmes zgjatjes së jetës funksionale të objekteve .

Të dhëna mbi objektet shkollore

- Në Kosovë ka gjithsej 1172 objekte shkollore të arsimit parauniversitar publik.
- Ekzistojnë gjithsej 42 objekte të arsimit universitar publik në 7 universitete.
- Deri në vitin 1970, në Kosovë ka pasur 273 objekte shkollore të arsimit fillor dhe të mesme.
- Ndërkaq 451 objekte shkollore fillore dhe të mesme, janë ndërtuar prej vitit 1971 deri në vitin 1999.
- Pas vitit 2000, në Kosovë janë 402 objekte shkollore të nivelit fillor dhe të mesëm që janë ndërtuar.
- Në Kosovë janë 271 objekte shkollore me mure masive dhe 901 objekte me sistem skeletor nga betonarmeja në arsimin parauniversitar (përshkrim i gjendjes).
- Në Kosovë ka 22 objekte në arsimin e lartë të ndërtuara deri në vitin 1970 dhe 20 objekte me sistem skeletor nga betonarmeja (përshkrim i gjendjes).
- Në Kosovë ka afër 900 objekte shkollore fillore dhe të mesme me tualete jo funksionale
 - Prej tyre mënyra e nxehtjes :
 - a/ me nxehte qendrore.....36 objekte
 - b/ me nxehte vetjake.....489 objekte
 - c/ me naftë.....84 objekte
 - d/ me thëngjill127 objekte
 - e/ solare.....5 objekte
 - f/ të tjera37objekte
 - g/ me stufa.....340 objekte.
 - Ndërsa sa i përket furnizimit me ujë nga pusi, në tërë territorin e Kosovës janë 405 objekte shkollore të nivelit fillor dhe të mesëm.



MIRËMBAJTJA HIGJENIKE E HAPËSIRAVE TË BRENDSHME

Mirëmbajtja higjienike, sanitare nënkupton higjienën - pastrimin e të gjitha hapësirave edukativo-arsimore dhe shkencore të nyjeve sanitare, orendive dhe pajisjeve tjera. Me higjienën dhe pastrimin përfshihen aktivitetet e personave përgjegjës për të krijuar mjedise të shëndetshme për mbajtjen e proceseve arsimore dhe shkencore me mundësi të zbatimit të efektshëm të kurrikulave arsimore.

Që mirëmbajtja higjienike të jetë në kohën dhe nivelin e duhur fillimisht duhet të respektohen disa rregulla gjenerale dhe të menaxhohen nga menaxhmentet e institucioneve përmes faktorit informues si:

- Të mbahen të pastërta dhe me rregull të gjitha hapësirat e institucioneve.
- Hapësirat shkollore të mbahen të mbyllura kur ato nuk përdoren.
- Të gjithë shfrytëzuesit e institucionit të mos mbështeten në mure.
- Orenditë të jenë në distancë nga muret që të mos prekin ato.
- Të mos hidhen mbeturinat në dysheme apo në oborrin e shkollës , ato të vendosen në kontejnerët përkatës.
- Tualetet të mos përdoren kur nuk ka ujë (të sigurohet furnizimi mobil me ujë).
- Të mos hidhet asgjë në guaca , pisoarë apo lavamanë(në tualete).
- Të mbyllen gjithmonë krojet kur kryhen pastrimet.

Përgjegjësitë për higjienë të objekteve arsimore

Kryerja e pastrimit të hapësirave në objektet arsimore bëhet nga punëtorët teknik ose organizatat e angazhuara për shërbime pastrimi, bazuar në rregulloret e brendshme të institucioneve edukativo-arsimore dhe shkencore si dhe rregulloreve komunale .

Pastrimi në baza javore kryhet në tërësinë e objekteve, ose në baza periodike . Gjithashtu pastrimi mund të kryhet edhe nga komuniteti, nxënësit etj.

Materialet për pastrim sigurohen bazuar në rregulloret e komunave dhe institucioneve arsimore dhe shkencore për ndërtesa arsimore. Ato duhet të jenë ekologjike dhe të shëndetshme si dhe konform standardeve evropiane të destinuara për pastrimin përkatës pa përbërje të dëmshme kimike.

Pastrimet kryhen në sasi kompatible për personel teknik bazuar në normat sipas rregulloreve komunale.

Pastrimet janë të vazhdueshme në tualete dhe laboratorë , në baza ditore në të gjitha hapësirat e brendshme si: dhomat, laboratorët, hapësirat për shumë qëllime dhe holle si dhe komunikatat horizontale-korridoret dhe ato vertikale shkallët , pjerrinat dhe ashensorët.

Ndërsa në baza javore bëhet pastrimi gjeneral i hapësirave të objekteve edukativo-arsimore dhe shkencore.

Në baza mujore pastrohen edhe mjediset e jashtme si oborret e institucioneve edukativo-arsimore dhe shkencore përfshirë edhe terrenet sportive derisa pjesët gjelbëruese në perioda të nevojshme natyrore.

Evidencimi dhe kontrollimi i nivelit të kryerjes së pastrimit, realizohet sipas rregulloreve të brendshme dhe kompetencave menaxheriale të menaxhmentit të

institucioneve edukativo-arsimore dhe shkencore , por preferohet një evidencë ditore dhe javore përmes një formulari .

Gjithashtu, kontrollimi realizohet edhe nga inspektorati sanitar në baza periodike.

Shpenzimet e pastrimit dhe higjienës realizohen përmes grantit specifik për kokë nxënësi të planifikuara nga qeveria, por mund të bëhet edhe nga donatorë të ndryshëm me vullnet të mirë.

Çka përfshin pastrimi dhe higjiena në objektin shkollor

Në objektet edukativo-arsimore dhe shkencore pastrohen:

- * dyshemetë,
- * dritaret,
- * dyert,
- * muret,

* orenditë (dollapët, vitrinat, bankat, karriget, lavamanët,) tabelat, trupat ndriçues, prizat, radiatorët dhe pajisjet tjera, të cilat janë të përfshira me normat e pastrimit.

Pastrimi kryhet në të gjitha pjesët e ndërtuara të objekteve edukativo-arsimore dhe shkencore si: hapësirat arsimore, shkencore , laboratorët, punëtoritë, kabinetet, tualetet për nxënës/studentë , personelin profesional dhe arsimor si dhe administrativ duke përfshirë edhe sallat e ngrënies, sallat e sportit, hapësirat ndihmëse ekonomike (të ngrohjes, depot e materialeve për ngrohje, depot për rekuizita të hapësirat administrative dhe ato të përbashkëta etj.)

Në objektet e institucioneve edukativo-arsimore dhe shkencore pastrohen edhe instalimet e ngrohjes si gypat e ndryshëm në të gjitha hapësirat gjatë shtrirjes së rrjetit të ngrohjes, po ashtu edhe trupat ngrohës, instalimet e ujit dhe ujëmbledhësve si ato në

hyrje të objekteve ashtu edhe në të gjitha hapësirat tjera.

Në hapësirat e jashtme pastrimi kryhet si në pjesët gjelbëruese ashtu edhe në rrugica dhe në fushat e hapura për sport dhe rekreacion dhe rrethojat e tyre, rrethojat e oborrit të objekteve edukativo-arsimore dhe shkencore

-- **Mënyra e pastrimit dhe materialet për pastrim**

1. Mënyra e pastrimit të dysHEMEVE nga PVC ose goma

Zgjidhja e problemit të pastrimit të dysHEMEVE nga PVC ose goma		
Problemi	Mënyra e pastrimit	Mjetet e nevojshme
Pastrimi i njollave nga lapsat me ngjyrë, salca e domateve, senfi, yndyrërat etj.	Njollat pastrohen me ujë të nxehtë në të cilin ka ilaç për pastrim; Sipërfaqja e dyshemesë pastrohet me leckë dhe lustrohet në pajtim me udhëzuesin e prodhuesit për dysheme.	Leckë; Ilaçe për pastrim; xhoker (leckë pastrimi); leckë dhe ilaçe për pastrim.
Pastrimi i njollave nga ndryshku.	Njollat nga ndryshku pastrohen me ujë në të cilin ka ilaç për pastrim; Sipërfaqja e dyshemesë pastrohet me leckë dhe lustrohet në pajtim me udhëzuesin e prodhuesit për dysheme.	Ilaç për pastrimin e ndryshkut; leckë; xhoker.

2. Mënyra e pastrimit të ulluqeve të ujit të objektit

Zgjidhja e problemeve të pastrimit të ulluqeve të ujit		
Problemi	Mënyra e pastrimit	Mjetet e nevojshme
Zënia e ulluqeve horizontale nga gjethet, degët dhe mbeturina të tjera.	Pastrimi i ulluqeve dhe mënjanimi i mbeturinave të tubuara; Largimi i rërës dhe lymit të mbledhur ; Larja e ulluqeve me gyp uji me sasi të madhe të ujit.	Shkallë; Doreza; Mjet për grumbullimin e mbeturinave (thasë, shporta, qese); Gyp.
Zënia e ulluqeve vertikale nga gjethet, degët dhe mbeturina të tjera.	Pastrimi i ulluqeve dhe mënjanimi i mbeturinave të tubuara; Largimi i ngricave të pa shkrira ose thuprave e fletëve të ndryshme të ngecura; Larja e ulluqeve me gyp uji me sasi të madhe të ujit.	Shkallë; Doreza; Mjet për grumbullimin e mbeturinave (thasë, shporta, qese); Tub uji.

3. Mënyra e pastrimit të oborreve të objekteve

Zgjidhja e problemeve të pastrimit të oborreve të objekteve edukativo-arsimore dhe shkencore		
Problemi	Mënyra e pastrimit	Mjetet e nevojshme
Gjethet të rëna	Grumbullimi i gjetheve dhe largimi nga oborri i shkollës.	Krehër kopshti; Qese; Doreza.
Mirëmbajtja e sipërfaqeve me barë	Kositja e sipërfaqeve me barë; Ujitja e sipërfaqeve me barë; Pastrimi i gjetheve dhe degëve të rëna; Gërvishtja e barit për t'u mënjeluar bari i thatë, gjethet etj.	Krehër kopshti; Qese; Doreza; Kosë; Gërshërë për bar

Trajtimi i mbeturinave:

Mbeturinat grumbullohen në vende të caktuara ku nuk përbëjnë rrezik shëndetësor dhe të lehtë për tu transportuar jashtë hapësirave arsimore dhe shkencore.

Grumbullimi lokal i mbeturinave bëhet në objekt dhe oborr të objekteve të institucioneve edukativo-arsimore në pajisje me vëllim të vogël në distanca të shkurta jo më shumë se 15 m’.

MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMET E NDËRTESAVE EDUKATIVO-ARSIMORE DHE SHKENCORE

A/ Mirëmbajtja e objekteve të ndërtuara

Mirëmbajtja e objekteve të ndërtuara edukativo-arsimore dhe shkencore nënkupton parandalimin e amortizimit ose dëmtimeve dhe defekteve në objekt gjatë shfrytëzimit, nën ndikimin e funksionit, si të hapësirave ashtu edhe instalimeve funksionalizuese në objekt.

Mirëmbajtja e objekteve të reja të ndërtuara fillon me marrjen e objektit në pronësi nga institucioni përkatës ose komuna. Objektet e reja dhe të renovuara për të qenë

funksionale për një kohë sa më të gjatë duhet të menaxhohen në mënyrë përkatëse dhe të mirëmbahen në kohë dhe në mënyrë profesionale.

Në mënyrë që mirëmbajtja e objekteve të ndërtuara të jetë në kohën dhe nivelin e duhur fillimisht duhet të respektohen disa rregulla gjenerale dhe të udhëhiqen dhe menaxhohen nga menaxhmentet e institucioneve përmes këshillimeve informuese si:

- Të mos ngjitet apo shpohet asgjë në mure e sidomos ato të jashtme.
- Të hapen dhe mbyllen krojet kujdesshëm dhe të mos sforcohen ato në drejtime jo adekuate.
- Të mos përplasen dyert apo dritaret, por ato të mbyllen me kujdes.
- Të mos hidhen gurë, gjësende apo topa në kulme.

- Të mos ngulen gozhda në mure të brendshme, ato bëhen vetëm nga personat përgjegjës.
- Të mbahen kafshët larg nga oborret e shkollave e sidomos larg nga burimet e ujit.
- Të raportohen të gjitha rastet te pjesëtarët e mirëmbajtjes ose arsimtari kryesor (personat përgjegjës).

- Mirëmbajtja e objekteve të ndërtuara ndahet në :

- 1. Mirëmbajtja në aspektin teknik e elementeve funksionale e cila përfshin:**
 - Ndërtimore-** ndërrimin e dorezave të dëmtuara të dyerve dhe dritareve së bashku me mekanizmat e hapje mbylljeve, montimin e lajsneve të ndryshme në dysHEME dhe dyer dhe dërrasave mbrojtëse në mure dhe hapësira tjera.

- Instalimeve të ujësjellës-kanalizimeve- , ndërrimin e ventileve të rrjetit të ujësjellësit në tualete, baterive të ujit, ventileve të jashtëm të ujërave të pa pastra, sanitarive (lavabo, pisoare, guaska të ëc-ve), etj.

- Instalimeve elektrike-ndërrimin e trupave ndriçues, prizave, çelësve elektrik të dëmtuar ose thyer, etj.

- Instalimeve të ngrohjes- ndërrimin e ventilave, trupave ngrohës, pompave termike, kaldasë, rezervarëve të lëndëve djegëse dhe pjesëve tjera fazonike etj.



2. Mirëmbajtja në aspektin ndërtimor dhe infrastrukturor përfshin:

-  Lyerjet e pjesshme ose të tërësishme të mureve të brendshme dhe atyre në fasadë në rast të shfaqjes së lagështisë dhe mykut ,
-  Lyerjen me ngjyrën adekuate përkatëse të konstruksioneve nga druri ose metali në ndërtesë në faza periodike,
-  Evitimin e plasurinave të shfaqura në mure të brendshme ose të jashtme që janë rezultat i ndryshimit të temperaturave, mungesës së dilatimeve ose pozicionimit të objektit në terren dhe të cilat nuk janë konstruktive,
-  Ndërrimin e numrit të limituar të dyerve të dëmtuara nga përdorimi ose në mënyrë të dhunshme,
-  Vendosjen e shtresës së fundit të dyshemesë në pjesë parciale të dëmtuara në sasi të vogël në një hapësirë dhe jo më shumë se 3 hapësira,
-  Ndërrimin e ndonjë xhami të thyer,
-  Rregullimin e mbulesave nga llamarina e plastifikuar ose tjegullat me mjeshtëri profesionale artizanale në rastet e dëmtimeve nga era ose ngrica ose efektet tjera atmosferike,
-  Pastrimin nga lymë-rëra dhe mbushja me mbeturina si gjethe dhe thupra dhe rregullimin e ulluqeve horizontale dhe vertikale në rastet e dëmtimeve të lidhjeve

ose dëmtimeve të shkaktuara nga akulli si dhe dëmtimet mekanike për raste të limituara,

- + Riparimin e pikoreve të jashtme dhe të brendshme të dritareve,
- + Testimi i rrufepritësit në faza periodike,
- + Rregullimin e rrufepritësit në kulm në pjerrtësi ose në mure vertikalisht, të dëmtuar nga natyra ose dëmtimet mekanike,
- + Lidhjen e instalimeve elektrike të dëmtuara dhe plotësimin me kapak ose izolimin e kutive të ndryshme elektrike nga kontakti fizik i mundshëm,
- + Përforcimin e lidhjeve dhe shtangimin e nyjeve në instalimet e ngrohjes në tërë rrjetin, etj.









Objektet e dëmtuara pjesërisht me vlerë financiare të vogël si ato që konsiderohen dëmtimet teknike funksionale po ashtu në sasi të limituar edhe ndërtimore dhe infrastrukturore, mund të kryhen nga nivelet komunale ose nga institucionet përkatëse me angazhimet e punëtorëve profesionist të mjeshtërisë dhe artizanateve.

Në rast të konstatimeve nga përgjegjësit kompetent si në nivelin komunal ashtu edhe në MASHT për dëmtimet , në bazë të të cilave ndërtesat konsiderohen të nevojshme për renovim të tërësishëm ose në sasi përmbajtësore që tejkalojnë mirëmbajtjet e objekteve, ato mund të jenë potenciale për investime kapitale, nga buxheti për investimet kapitale në komuna ose buxheti për investimet kapitale nga MASHT.

Financimi i mirëmbajtjeve të ndërtimit të objekteve arsimore realizohet përmes granteve qeveritare për komunat dhe bazuar

në të hyrat e gjeneruara ose të hyrat vetjake të shkollave (shkollat profesionale) po ashtu edhe nga donatorët ose komuniteti me vullnetin e mirë përmes institucionit edukativo-arsimor dhe shkencor ose komunave të arsimit parauniversitar.

Kontrollimi i nivelit të kryerjes së mirëmbajtjes së ndërtesave edukativo-arsimore dhe shkencore bëhet nga personat kompetent profesional të fushave përkatëse sipas pozicioneve të riparuar, të angazhuar në bashkëpunim me menaxhmentin e institucioneve ose nga personat kompetent profesional në komuna.

Mirëmbajtja e kontraktuar e objekteve të ndërtuara edukativo-arsimore dhe shkencore

Mirëmbajtje e objekteve të ndërtuara edukativo-arsimore dhe shkencore e

kontraktuar konsiderohet, kontraktimi i punëve me operator ekonomik nga komunat ose institucionet shkencore për kryerjen e punëve të cilësuar si mirëmbajtje në aspektin ndërtimor dhe infrastrukturor, të cilat kanë sasi më të konsiderueshme të dëmtimeve në objekt, por kur nuk përfshihen në tërësi të gjitha pozicionet e meremetimit të objektit, por vetëm disa pozicione meremetuese.

Mirëmbajtja e kontraktuar e objekteve të ndërtuara dhe në funksionalitet duhet të kryhet në koordinim me menaxhmentin e institucioneve edukativo-arsimore dhe shkencore deri kur nuk e pengon procesin edukativo-arsimor dhe shkencor.

Mirëmbajtja, riparimet me vëllime të mëdha në objekte kryhen të planifikuara në mënyrë që punimet të fillojnë në përfundim të vitit paraprak dhe para fillimit të vitit shkollor dhe akademik.

Pozicionet për mirëmbajtje të kontraktuar konsiderohen lysterja e sipërfaqeve të mureve të brendshme ose të fasadave me sasi për tërë objektin ose ndërrimi i numrit të konsiderueshëm të dyerve ose sanitarive dhe ventilave të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërrimi i numrit të konsiderueshëm të trupave ndriçues , pjesëve fazonike dhe ventilave të sistemit të ngrohjes ose një numri të konsiderueshëm të trupave ngrohës si dhe funksionalizimi i këtyre llojeve të instalimeve në objekt.

Po ashtu, edhe pozicionet e vendosjes shtresës së fundit të dyshemesë , të termoizolimeve në tavan ose në fasadë sikurse edhe izolimi i tualeteve, rivendosja e rrjeteve të brendshme të instalimeve në tualete dhe montimi i pllakave dhe sanitarisë si dhe funksionalizimi i tyre.

Financimi bëhet nga komunat të cilat i zhvillojnë procedurat e kontraktimit sipas

ligjit të prokurimit dhe planifikimit të financave, qoftë me investimet vetjake të institucioneve edukativo arsimore të shkollat profesionale dhe me planifikim dhe procedura të veçanta të institucioneve shkencore, të financimit nga komunat , institucionet shkencore ose të financimit nga donatorët e vullnetit të mirë për institucionet përkatëse .

Kontrollimi i nivelit të funksionalizimit të mirëmbajtjes së kontraktuar të pozicioneve të riparuar bëhet nga personat kompetent profesional të fushave përkatëse sipas pozicioneve të riparuar, të angazhuar nga nivelet komunale ose institucionet edukativo-arsimore dhe shkencore në bashkëpunim me menaxhmentin e institucioneve .

2/ Riparimet në objekte edukativo-arsimore dhe shkencore

Me riparime teknike dhe të ndërtimit në objektet edukativo- arsimore dhe shkencore, përfshihen puna mjeshtërore dhe artizanale për kryerjen e mirëmbajtjes :

1. Në aspektin teknik
2. Në aspektin ndërtimor dhe infrastrukturor, të cekura më lartë.

Që të kryhen riparimet e nevojshme fillimisht duhet të zhvillohen disa kontrole të objekteve edukativo-arsimore dhe shkencore në faza periodike mujore para planifikimit të aktiviteteve që do të ndërmerren:

Kontrollet në oborr:

- Kontrollimi i të gjitha mbeturinave nga olluqet dhe rigollat e ndryshme dhe dëmtimit të tyre.

- Kontrollimi i pusetave dhe funksionimi i tyre.
- Kontrollimi i tubave, nyjeve dhe krojeve në sistem të ujësjellësit.
- Kontrollimi i rrethojës së oborrit.

Kontrollet e objekteve nga jashtë :

- Kontrollimi i mureve të fasadave dhe strehëve se mos janë fole zogjsh apo grafite.
- Kontrollimi i kulmeve për përmbajtje të mbeturinave dhe gjetheve.
- Kontrollimi i kulmeve nga llamarina se mos ka mungesa bulonash, apo dëmtime tjera etj.
- Kontrollimi i tavaneve-plafonëve të jashtme për shenja lagështie.
- Kontrollimi i pajisjeve ndriçuese të jashtme, a janë funksionale .
- Kontrollimi i hijezuesve se a janë të fiksuara dhe të sigurohen nga erërat e forta.

Kontrollet në brendi të objekteve :

- Kontrollimi i tavaneve për shenja lagështie.
- Kontrollimi i dyshemeve se mos paraqiten qarje, fryrje apo dëmtime tjera.
- Kontrollimi i dyerve, a mbyllen mirë ; kontrollimi i dorezave dhe bagllamave
- Kontrollimi i çelësave dhe numrit të tyre, a janë të gjithë apo mungon ndonjë.
- Kontrollimi i dritareve a mbyllen mirë.
- Kontrollimi i tualeteve a janë funksionale.
- Kontrollimi i krojeve, sifonave, ujëmbledhësve dhe ekventilave në përgjithësi për rrjedhje.

- Kontrollimi i ndërprerësve dhe prizave elektrike si dhe llampave, a janë funksionale .
- Kontrollimi i siguresave elektrike a funksionojnë si duhet.
- Kontrollimi i orendive për dëmtimet e ndryshme.
- Kontrollimi i sistemit të ngrohjes.

Riparimet në aspektin ndërtimor dhe infrastrukturor duhet të kryhen në perioda vjetore.

Riparimet me sasi të vogël mund të kryhen me angazhimet e punëtorëve profesional në nivel të institucionit ose komunal deri në sasi që e lejon ligji i prokurimit dhe financave, derisa kur kemi të bëjmë me sasi të konsiderueshme atëherë ato kryhen sipas kontratës nga komunat ose institucionet përkatëse.

Në tabela po japim shembuj të zgjidhjes së problemeve funksionale të shfaqura gjatë funksionimit të objekteve edukativo-arsimore dhe shkencore dhe mënyrat e riparimeve në aspektin teknik në disa pozicione të shfaqura në rastet më të shpeshta:

1. Riparimi i problemeve të shfaqura gjatë përdorimit të dritareve dhe dritareve

Zgjidhja e problemeve gjatë përdorimit të dritareve dhe dritareve		
Problemet e shfaqura	Aktiviteti që ndërmerret	Mjetet e nevojshme
Funksionim i vështirësuar i mekanizmave.	Shtrengimi.	Çelës - inbus
Mosfunksionimi i mekanizmave të hapje-mbylljeve	Ndërrimi i tyre me te re	Kaçavidë Çekan
Lagështia e xhamit	Silikonizimi.	Kaçavidë; Çelës - inbus; Çekan prej druri
Doreza të dëmtuara	Ndërrimi.	Kaçavidë; Çelës - inbus; Turjelë, shpuese

2. Riparimi i problemeve të shfaqura në funksionimin e ulluqeve të ujit

Zgjidhja e problemeve me mosfunksionimin e ulluqeve të ujit		
Problemet e shfaqura	Aktiviteti që ndërmerret	Mjetet e nevojshme
Dëmtimi i ulluqeve, ulluk i prerë (kur mungon një modul- copë) dhe derdhja jo e drejtë e ujit atmosferik.	Duhet të ndërrohen pjesët e dëmtuara dhe mbajtësit me: Përcaktimin e gjatësisë së pjesës së dëmtuar; Heqjen e mbajtësve të ulluqeve dhe heqjen e pjesës së dëmtuar; Montimi i pjesës së re të ullukut dhe forcimi me mbajtës të rinj.	Turjelë, shpuese Silikon; Vida.

Çarja e ulluqeve gjatë periudhës së dimrit për shkak të qëndrimit të ujit atmosferik dhe ngrirjes së ujit.	Nëse ka rrjedhje të ujit nga vetë ulluqet, nevojitet: Përcaktimi i vendit të rrjedhjes, Lyerja me silikon; Nivelimi i ulluqeve horizontale, në rast kur rrëzimi nuk është i drejtë vjen deri te grumbullimi i ujit.	Turjelë, shpuese; Silikon; Gozhda.
Dëmtimi i sipërfaqeve të mureve dhe tavaneve nga grumbullimi i ujit atmosferik në ulluqe.	Riparimi apo pastrimi i ulluqeve; Pastrimi i njollave nga lagështia në mure dhe tavane; Lyerja e njollave me një shtresë (prajmer); Lyerja e murit dhe tavanit	Turjelë, shpuese; Silikon; Gozhda.

3. Riparimi i plasurinave të shfaqura në mure dhe mënjanimi i grafitëve

Zgjidhja e problemeve të çarjes së mureve dhe mënjanimi i grafitëve nga fasada		
Problemet e shfaqura	Aktiviteti që ndërmerret	Mjetet e nevojshme
Çarja e mureve	Pastrimi i bazës; Vlerësimi i thellësisë së çarjes; Mbushja e pjesës së çarë me rrëshirë epokside apo llaç; Nivelim me shpatull për të mos pasur gunga; Lyerje.	Pastruese për mur (gërryese); Furçë; Rulë sfungjeri
Grafitë në fasada	Pastrimi i sipërfaqes; Vendosja e prajmerit si bazë. Prajmeri paraqet lyerjen bazë, gjegjësisht shtresën lidhëse të substratit. Aplikohet një shtresë	Furçë; Rulë sfungjeri

	me furçë; Pas aplikimit të lyerjes bazë është e nevojshme të bëhet aplikimi final me bojë. Boja duhet të aplikohet mirë dhe të cilësohet me rezistencë të lartë të ujit dhe qëndrueshmëri gjatë kushteve të ndryshme klimatike	
--	--	--

4. Evitimi i lagështisë dhe mykut të shfaqur në mure dhe tavan

Zgjidhja e problemeve të paraqitjes së lagështisë dhe lyerja e mureve dhe tavaneve në të cilat ka njolla lagështie		
Problemet e shfaqura	Aktivitetet që ndërmerren	Mjetet e nevojshme

Paraqitja e lagështisë në tavane dhe në muret e brendshme; Paraqitja e lagështisë në dysHEME.	Zbulimi i shkaktarit të lagështisë; Sanimi i shkaktit: riparimi i çatisë, ulluqeve, hidroizolimi, mënjanimi i lagështisë kapilare.	Shkallë; Turjelë, shpuesë; Silikon; Gozhda; Doreza.
Lyerja e mureve të brendshme të cilat kanë njolla të lagështisë.	Sipërfaqet pastrohen që të mënjanohet pluhur nga muret; Aplikimi i lyerjes përkatëse bazë; Lyerja e murit me aplikim të barabartë të bojës. Gjatë lyerjes finale të sipërfaqeve rula duhet lëvizur prej lartë-poshtë dhe anasjelltas, me ç'rast sipërfaqja e murit merr pamje të balancuar; Intervali kohor prej aplikimit të parë deri në aplikimin e shtresës së dytë duhet të jetë 4–6orë.	Leckë gjysmë e lagur; Pastrues për mur; Furçë; Rulë sfungjeri



VINI RE!

Lyerja e mureve të brendshme bëhet në interval kohor prej tre deri në pesë vjet.

Muret duhet lyer me bojëra të ndritshme ndërsa tavanet me bojë të bardhë.

Boja mbrojtëse e mureve aplikohet në lartësi prej 1,2 metrash.

KUJDES ÇFARË BOJËRASH BLINI!

Ato duhet:

- ▶ Të jenë me bazë uji;
- ▶ Të mos përmbajnë aceton, amoniak apo formaldehidit;
- ▶ Të mos përmbajnë metale të rënda dhe kompozime organike të paqëndrueshme.

5. Riparimi i dysHEMEVE të dëmtuara nga PVC dhe goma

Zgjidhja e problemeve të dysHEMEVE të dëmtuara nga PVC dhe goma		
Problemet e shfaqura	Aktiviteti që ndërmerret	Mjetet e nevojshme
Pjesë të shkëputura të dysHEMESË prej PVC-së ose gomës.	Nevojitet të bëhet kontrolli i dysHEMESË së vendosur prej PVC-së ose gomës; Nëse ekzistojnë pjesë të shkëputura nevojitet të bëhet vendosja e një mjeti lidhës midis dysHEMESË dhe PVC-së apo gomës dhe shtresës ekzistuese të dysHEMESË- estrih, kjo behet pas pastrimit te materialeve ekzistuese të shtresës së dëmtuar.	Pastruese për mur; Rulë.
Sipërfaqe të dëmtuara si rezultat i ndërrimit jo të rregullt të shtresave të mobilieve (banka dhe	Vendoset mjet lidhës midis dysHEMESË prej PVC-së apo gomës dhe shtresës ekzistuese të dysHEMESË;	Pastruese për mur; Rulë; Turjelë, shpuese.

karrige).	Aplikohet me rulë që të mënjanohet teprica e materialit, si dhe të bëhet shtypje që më mirë të aplikohet mjeti lidhës; Vendoset gjësend i rëndë, i cili duhet të qëndrojë 12 orë, që të mundësohet bashkim më i mirë; Aplikohet lyerja finale që të bashkohen skajet e dy pjesëve për të mos u shkëputur pjesa e dëmtuar.	
-----------	--	--

6. Riparimi i pajisjeve sanitare në tualete

Zgjidhja e problemeve të pajisjeve sanitare në tualete		
Problemet e shfaqura	Aktiviteti që ndërmerret	Mjetet e nevojshme
Riparimi i kasetës së tualetit ku vazhdimisht rrjedh nga pak ujë në guackë.	Ekzistojnë dy mënyra të riparimit të kazanit: Hiqeni kapakun e kazanit, nëse uji derdhet jashtë gypit për rrjedhje, kjo do të thotë se defekti qëndron te mbushësi. Tërhiqeni galixhantin lartë dhe nëse uji ndalon së rrjedhuri, nevojitet vetëm rregullimi i nivelit të ujit, pa ndërruar asgjë; Në rast se rrjedh uji, pasi të tërhiqet galixhanti me dorë, duhet të riparohet ose të ndërrohet ventili. Fillimisht duhet të shkyçet përçimi i ujit në kasetë (mbyllet ventili para gypit	Dara; Kaçavidë; Burgi.

	fleksibil) dhe demontohet pjesa e ventilin ku bën pjesë galixhanti, ndërsa më pas ndërrohet me një të ri.	
Riparimi i përçuesit të ujit.	Për të liruar përçuesin e ujit në lavaman ekzistojnë tri mënyra: Mjeti për lirim – nuk duhet të përdoret në rast se gypat janë zënë në tërësi. Gjithmonë duhet të ndiqet udhëzuesi i prodhuesit; Përdorimi i gomës nën vakum – kur përdoret goma, në lavaman duhet pasur ujë. Vendosni gomën mbi përçuesin e lavamanit dhe lëvizeni dorezën lartë-poshtë. Goma gjatë tërë kohës duhet të jetë në mes të përçuesit që të jetë statik; Pastrimi i sifonit – Fillimisht lirojeni sifonin me çelës përkatës dhe hiqeni. Më pas merrni një enë për mbledhjen e ujit i cili do të derdhet, ndërsa më pas vendoseni sifonin e ri. Kur ta ndërroni	Dara; Kaçavidë; Gomë nën vakum; Burji.

	sifonin, kontrolloni nëse gomat janë të shtrënguara dhe të forta, pasi që nëse janë të çliruara dhe të buta nuk do të qëndrojnë dhe sifoni do të rrjedh.	
Riparimi i çezmave, rubinetave dhe ventileve.	Ndërrimi i gomave; Ndërrimi i ventilit; Ndërrimi i çezmave	Dara; Kaçavidë; Burgj.

7. Riparimet në rrjetin e ngrohjes

Zgjidhja e problemeve të rrjetit të ngrohjes		
Problemet e shfaqura	Aktiviteti që ndërmerret	Mjetet e nevojshme
Rrjedhja e ujit prej pjesëve lidhëse të gypat në rrjet, prej ventilatorëve	Izolimi i defektit me mbylljen e ventilëve; Ftohja e sistemit; Derdhja e ujit prej sistemit (nëse është e nevojshme);	Garnitura të kaçavidave, çelësave, çelësive inbus, darëve; Sharrë hekuri;

dhe prej fitingjeve.	Nëse sistemi është i mbushur me antifriz, është e nevojshme të mblidhet gjatë rrjedhjes dhe të deponohet; Ndërrimi i pjesëve lidhëse, ventileve dhe fitingjeve	Material për ngjitje: ngjitëse, litar; shirit i telefonit, shirit ngjitës; Instrumente matëse: shirit për matje, kalibër për matje; Veshje pune dhe sigurie, këpucë, doreza dhe syza.
Rrjedhje prej gypit.	Ndërrimi i një pjese ose i të gjithë gypit (vendimi merret aty për aty); Vendosja e gypit të ri; Ngjitja e gypit të ri me instalimin ekzistues (nëse gypi është prej çelikut, bashkimi bëhet me vidhë ose ngjitje, nëse është gyp prej bakrit bashkimi bëhet me ngjitje, nëse është zorrë prej aluplasti atëherë e gjithë gypi ndërrohet); Pas riparimit zorra testohet në të ftohtë, në shtypje hidrostatike për	Garnitura të kaçavidave, çelësave, çelësave inbus, darëve; Fresibël i vogël dhe furçë teli; Sharrë hekuri; Material për ngjitje: ngjitëse, litar; shirit, gjitës; Brusha , rula për bojëra; Veshje pune dhe

	50% më shumë se sa ai punues; Pas testimit vendoset mbrojtje anti-korezionit dhe lëshohet në punë ajo pjesë e instalimit.	sigurie, këpucë, doreza dhe syza.
Rrjedhje prej radiatorit.	Mbyllen ventilet e radiatorëve dhe çmontohet i gjithë radiator; Nëse radiator është prej gizës apo çelikut, pjesët ku është bërë problemi ndërrohen me të reja, ndërsa te radiatorët e tjerë bëhet zëvendësim i plotë me radiator të ri; Larja me ujë dhe testimi me shtypje hidrostatike 50% më shumë se sa ai i punës, para se të montohet në instalim; Montimi i instalimit; Lirimi i ajrit përmes ventililit termorregullues.	Garnitura të kaçavidave, çelësave, çelësave inbus, darëve; Material për ngjitje; Veshje pune dhe sigurie, këpucë, doreza dhe syza

8. Riparimet gjatë mirëmbajtjes së oborreve

Zgjidhja e problemeve të mirëmbajtjes së oborreve në objektet edukativo-arsimore dhe shkencore		
Problemet e shfaqura	Aktivitetet e ndërmarra	Mjetet e nevojshme
Mirëmbajtja e drunjve, shkurreve dhe gardhit	Mënjanimi i rregullt i degëve të vjetra të vdekura; Krasitja e rregullt e gardhit dhe formësimi i tij; Shkurtimi i rregullt i drunjve.	Makinë elektrike për formësimin e gardhit; Gërshërë për gardh dhe krasitje; Lopatë; Krehër kopshti; Dorezë.
Mirëmbajtja e rrethojës së shkollës.	Lyerja e rrethojës bëhet në interval kohor prej 3 deri në 5 vjet; Lyerja e rregullt e shulave të dyerve, bravave në dyert hyrëse	Furçë; Doreza.

3/ Mirëmbajtja dhe riparimet e orendive në objektet arsimore

-- Çka konsiderojmë me mirëmbajtje dhe riparime të orendive

Me mirëmbajtje dhe riparime të orendive-inventarit në objektet edukativo-arsimore dhe shkencore konsiderojmë trajtimin e drejt dhe evitimin ose riparimin e dëmtimeve të karrigeve, bankave, lavamanëve të laboratorëve , vitrinave dhe dollapëve të ndryshëm si dhe mjeteve tjera për shpjegim dhe punë në laboratorë në zbatim të plotë të kurrikulave arsimore.

Përgjegjësit për orenditë në objektet arsimore

Me rastin e furnizimit dhe pranimit të inventarit dhe orendive në pronësi të

institucionit edukativo-arsimor dhe shkencor, përgjegjësia për trajtim dhe mirëmbajtje i takon institucionit përkatës, i cili e ka në pronësi inventarin dhe orenditë në kuptim të përgjithshëm dhe të secilit shfrytëzues në kuptim individual.

Riparimet ose montimet e pjesëve të shkëputura të konstruksioneve të orendive të cilat mund të funksionalizohen me riparim ato mund të kryhen nga institucioni me punë praktike, me angazhim të një punëtori profesional ose me koordinim me ndonjë shkollë profesionale ku njëkohësisht kryhen aftësimet profesionale të montimeve dhe riparimeve të orendive në drejtimet përkatëse mësimore ose studimore.

Po ashtu mund të kryhen edhe nga nivelet komunale me kontraktim në rastet e sasive të mëdha për riparime, si dhe nga komuniteti me vullnetin e mirë.

Financimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të orendive në objektet arsimore dhe shkencore mund të kryhet me të hyrat e institucioneve , ato komunale nga buxheti i granteve komunale për kokë nxënësi të arsimit parauniversitar ose nga donacionet e vullnetit të mirë.

Kontrollimi i nivelit të kryerjes së mirëmbajtjes dhe riparimeve të orendive në objektet arsimore bëhet nga komisioni i angazhuar në institucion me përbërje edhe të punëtorëve profesional në menaxhmentin e institucioneve edukativo-arsimore dhe shkencore.

Jetëgjatësia e orendive në objektet edukativo-arsimore dhe shkencore varësisht prej llojit, mund të jetë prej 5-7 vjet .



MBROJTJA E MJEDISEVE DHE OBJEKTEVE ARSIMORE

Mbrojtja fizike e hapësirave arsimore dhe shkencore

Mbrojtja nga sulmet e jashtme nënkupton mbrojtje të hapësirave të jashtme të oborreve dhe objekteve edukativo-arsimore dhe shkencore nga ndikimet e jashtme të komunikacionit ose veprimtarive tjera në vendbanime:

Me muret (gardhet e ndryshme) të nevojshme dhe konfiguracioneve të terrenit në oborre mund të krijohet mbrojtje nga rrugët me komunikacion të zhvilluar dhe zhvillimet në vendbanimet jashtë aktivitetëve edukativo-arsimore dhe shkencore.

Po ashtu, për mbrojtje të shfrytëzuesve bëhet shenjëzim dhe mbrojtje me ndonjë gardh të përkohshëm në oborr në rast të ekzistencës së ndonjë pengese, gjëmadhe të objekteve të dikurshme ose terreni të punës që ka mbetur i hapur.

Në objekt, mbrojtje konsiderohet posedimi i rrufepritësit, shkallëve kundër zjarrit, posedimit të hidrantëve si atyre brenda në objekt ashtu edhe atyre të jashtëm.

Mbrojtja nga defektet e mundshme në ndërtesë ose në rast zjarri përfshin pajisjen e objekteve me hidrantët e nevojshëm në distanca të duhura brenda objektit, pajisja me dyer kundër zjarrit në distanca të nevojshme në pjesë të objektit-llamella, dhe ato në dalje te shkallët emergjente si dhe pajisja me planin dhe shenjëzimin e evakuimit në raste emergjente, e cila vendoset në vende të dukshme të hapësirave të objektit.

Mbrojtja nga materialet ndërtimore të dëmshme në ndërtesë

Mbrojtja nga materialet me rrezatime jo të shëndetshme përfshin; mosaplikimi i dyshemeve me imitime me rrezatim jo të shëndetshëm si dyshemetë me PVC prej materialeve me rrezatim, pastaj nuk lejohet në asnjë mënyrë përdorimi i vajrave motorike për dyshemetë prej druri të cilat janë të dëmshme për shëndetin e shfrytëzuesve , të mbulesave me rrezatim me rrezik për shëndetin e shfrytëzuesve si ato prej salloniteve të rrafshëta ose të valëzuara të cilat duhet të ndërrohen urgjent .

Mbrojtja nga materialet dhe pajisjet e amortizuara dhe me rrezikshmëri përfshin pajisjen e objekteve edukativo-arsimore dhe shkencore me pajisjet mbrojtëse për laboratorët, kabinetet dhe punëtoritë për mbrojtje nga puna me materiale konkretizuese

si dhe kontrollimi i funksionimit të tyre gjatë procesit të konkretizimit në zbatim të plotë të kurrikulave për të gjitha nivelet arsimore.

Pajisja e ambienteve me dysHEME, inventarizim etj. me materiale që i plotësojnë kushtet e sigurisë varësisht prej funksionit që kryhet në to.

Mbrojtja gjatë procesit të konkretizimit të mësimin në punëtori dhe laboratorë me pajisje elektrike dhe me gaz, duhet të bëhet përmes pajisjeve automatike sipas normave të prodhuesve evropian të cilat në rast të përdorimit të pajisjeve dhe energjisë në mënyrë jo të drejtë , të gjitha pajisjet dhe furnizimet me energji të ndërpriten automatikisht.

Mbrojtja nga insolimi i tepërt ose mungesa e dritës në objekt

Krijimi i pengesave të jashtme dhe të brendshme prej rrezatimit pa penguar dritën natyrale që nënkupton vendosjen e brisolejeve të ndryshme- pengesave të diellit ose perdeve të ndryshme në ambiente të brendshme. Këto bëhen me materiale të ndryshme varësisht prej hapësirave që duhet të vendosen mbi dritare të dhomave të mësimin në pjesën e jashtme, brisolej- pengesa të diellit prej copave horizontale prej xhamave me korniza alumini, prej profileve të aluminit të vendosura horizontalisht si profile me dizajn shkallë me alumin me pjerrtësi etj.

Arritja e ndriçimit të mjaftueshëm në të gjitha hapësirat e ndërtesave edukativo arsimore dhe shkencore do të thotë që në të gjitha hapësirat ku ka komunikim ose numër të konsiderueshëm të nxënësve, fëmijëve ose

studentëve të ketë ndriçim të mjaftueshëm natyror të arritur me hapjet-dritaret në mure (dritaret) ose edhe në ato në tavan-mbulesa (kupola ose llanterna të ndryshme) ku ka objekte me etazhitet përdhese ose në katet e larta .

Në rast të mungesës së ndriçimit natyror ose pamundësisë së vendosjes së dritareve vetëm për hapësirat sekondare-ndihmëse, sepse në dhoma të zhvillimit të procesit edukativo-arsimor dhe shkencor patjetër duhet të ketë ndriçim natyror (shih udhëzuesin për norma dhe standarde të ndërtesave shkollore), atëherë në ambientet sekondare vendoset një sistem i ndriçimit artificial me poqa elektrik të mjaftueshëm dhe lehtë të ndezshëm.

Mbrojtja nga rreziqet natyrore të mundshme

Mbrojtja e ndërtesave nga dukuritë natyrore aktivizohet përmes mekanizmave mbrojtës të funksionimit të mbledhjes së ujërave në oborr në rast të vërshimeve ose bllokimit të sistemit të ujit në rast shpërthimi në objekt. Posedimi i objekteve me pajisje të ndihmës së parë ose mjeteve tjera si vegla për demolim të dyerve në rast të bllokimeve , të hapjes së kanaleve në rast të vërshimeve nga uji, të veglave për bartje në ujërat e vërshimeve dhe pajisje mjekësore emergjente për rastet e goditjeve nga rrufeja ose pasojave nga zjarri në rast zjarri si dhe pajisjeve zjarrduruese për evakuim dhe atyre për fikje të zjarrit të cilat vendosen në distanca të caktuara në objekt.

Mbrojtja e të angazhuarve gjatë procesit të mirëmbajtjes

Mjetet e punës për stafin që kryen mirëmbajtjet duhet ti posedoj çdo institucion edukativo-arsimor dhe shkencor, të cilat përdoren nga personi i cili do të kryente riparime dhe mirëmbajtje të objekteve edukativo-arsimore dhe shkencore si në aspektin teknik ashtu edhe në atë ndërtimor dhe infrastrukturor dhe gjithashtu edhe ato për mbrojtje në rast të fatkeqësive natyrore dhe njerëzore në objekt.

Mirëmbajtja dhe funksionalizimi i nyjeve sanitare në objektet edukativo-arsimore dhe shkencore me angazhim të partneritetit publiko-privat

Deri në momentin kur të krijohet baza ligjore përkatëse, çështja e partneritetit publiko – privat lidhur me mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e objekteve edukativo-arsimore shkencore duhet të zhvillohet mbi bazën e tanishme ligjore funksionale.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër
Bogdani”

37:69.059(036)

Udhëzues për mirëmbajtje dhe mbrojtjes të
objekteve arsimore / [përgatiten] Isuf Gashi...[et al.].
– Prishtinë : Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
2020. – 50 f. : ilustr. ; 21 cm.

1.Gashi, Isuf

ISBN 978-9951-16-130-5